



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-24-0696

Në ankesën e

Paditësi/ankuesi

H H nga Prishtina, i përfaqësuar nga avokati **B I** nga Prishtina.

Kundër

E paditura

N.SH. Banka Themelore e Kosovës "BANKKOS" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Asllan Krasniqi dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-II-15-0067 të datës 2 gusht 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-II-15-0067 i datës 2 gusht 2024.**
- 3. Obligohet AKP-ja- Autoriteti i Likuidimit që ti paguaj paditësit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës shumë prej 1,500.00 euro, interesin ligjor prej 10 % të shumës së borxhit kryesor në shumë prej 150.00 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, të cilat do të**

paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Me datë 15 nëntor 2015, përmes postës paditësi e dorëzoi në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN125-0905 të datës 12 dhjetor 2014, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme, kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shume prej 2,800.00 euro nga NSH "Banka Themelore e Kosovës-Bankkos" (në likuidim), me arsyetimin që paditësit i është përfunduar në bazë të Librezës së Punës marrëdhënia e punës me datë 14 dhjetor 1990, andaj atij nuk i është pushuar marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së për të pasur të drejtë në kompensim. Autoriteti i Likuidimit konstaton se paditësi nuk e gëzon të drejtën në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Në ankesë paditësi i kundërshton këto konstatime të Autoritetit të Likuidimit duke i konsideruar si të pa bazuara, pasi që ai pohon se në NSH ka punuar deri me datën 4 qershor 2013 kur NSH-ja ka hyrë në likuidim. Paditësi pohon se e ka pranuar njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 4 qershor 2013 dhe bazuar në këtë njoftim është paraqitur tek Autoriteti i Likuidimit. Bashkë me ankesë ka bashkangjitur Kopjen e Librezës së punës , listën për 20 % dhe autorizimin e avokatit.

Me datë 25 nëntor 2015, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të theksoi në ankesë se cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se ky Vendim nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore, prandaj nuk ka bazë të shfuqizohet. Tutje AKP-ja pohon se paditësit i është përfunduar në bazë të Librezës së Punës marrëdhënia e punës me datë 14 dhjetor 1990, andaj atij nuk i është pushuar marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së për të pasur të drejtë në kompensim. Autoriteti i Likuidimit konstaton se paditësi nuk e gëzon të drejtën në

kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në bazë të nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Me datë 15 tetor 2015, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i përsëritë pohimet e tij lidhur me kërkesën të cekura në mbrojtje në ankesë, ndërsa i kundërshton pretendimet e AKP-së të cekura në mbrojtje në ankesë duke i konsideruar si të pazuar në ligj. Paditësi me këtë parashtresë dorëzon Kopjen e Librezës së punës, Listën për 20 % dhe autorizimin e avokatit, dhe dy lista të Reiffeisen Banka lidhur me pagat, një Listë të punëtorëve të regjistruar të NSH-së.

Me datë 14 janar 2016, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS kundërpërgjigjen. Në kundërpërgjigje AKP-ja ka pohuar se paditësi pas vitit 1990 ka pohuar vet se nuk ka marrë ndonjë pagë nga NSH-ja, duke qenë se ajo nuk ka ushtruar aktivitet ekonomik, andaj paditësi nuk ka pësuar ndonjë dëme me veprim të AKP-së, për të pasur të drejtë në kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Me datë 02 shkurt 2024, shkalla e I-rë e DHPGJS-së e lëshon një Urdhër për paditësin dhe për AKP-në dhe palëve u kërkon të dorëzojnë prova për punësimin e fundit në NSH, vendime për pushim vjetor, ndonjë listë të pagave, llogari bankare etj.

Me datë 13 shkurt 2024, AKP-ja si përgjigje ndaj Urdhrit e dorëzon një parashtresë në DHPGJS, dhe me këtë parashtresë dorëzon, formularin e kërkesës, Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe Vendimin për fillimin e Likuidimit dhe emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 09,06.2013 dhe Listën për 20%.

Me datë 21 shkurt 2024, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë si përgjigje ndaj Urdhrit. Me këtë parashtresë paditësi i ka përsëritur pretendimet e veta se ka të drejtë në kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, pasi që ai ka dëshmi se marrëdhënia e punës në NSH i është ndërprerë për shkak të likuidimit të NSH-së me datë 04.06.2013. Paditësi në këtë parashtresë në emër të kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës kërkon shumën prej 1,500.00 euro, interesin ligjor prej 10% në shumë prej 150.00 euro dhe shpenzimet e përfaqësimit prej 229

euro. Bashkë me këtë parashtrësë ai dorëzon kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 04.06.2013, dy Lista të bankave lidhur me pagat e punëtorëve, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe Listën e AKP-së për drejtën legjitime për 20%.

Me datë 02 gushtë 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-II-15-0067 C0001 e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRZ 125- 0905, kërkesa e H H për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën 2,800.00€, është refuzuar, me arsyetim se paditësi nuk ka qenë punëtor aktiv në NSH duke konstatuar se Libreza e punës është mbyllur më datë 14.12.1990, dhe si rrjedhojë e kësaj paditësi, nuk u pushua nga puna si pasojë e veprimit të ndërmarr nga AKP-ja. Gjykata vlerëson se një konstatim i tillë në arsyetim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit është kundërthënës me provën e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës më datë 04.06.2013, të lëshuar nga AKP-ja, që do të thotë se edhe arsyetimi i vendimit por edhe parashtrësat e dorëzuara nga AKP, nuk përmbajnë argumente të mbështetura lidhur me faktin se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës nuk është shkaktuar me veprimin e AKP-së. Gjykata bazuar në Librezën punës sipas të cilës paditësit ju është mbyllur më datë 14.12.1990, Libreza e punës, kjo mbyllje është bërë për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës si për paditësin ashtu edhe për punëtorët tjerë, për shkak të fillimit të procedurës së falimentimit ndaj Bankës Themelore, të iniciuar nga Banka Popullore e Jugosllavisë në gjykatën kompetente në Beograd. Gjykata konstaton se pas përfundimit të luftës në Kosovë, paditësi sikundër të gjithë punëtorët tjerë, janë kthyer në punë në NSH si institucion financiar dhe të njëjtit ju është hapur Libreza e punës përsëri më dt. 01.09.1999 dhe ju është mbyllur më dt. 04.06.2013, në ditën kur paditësi ju është dorëzuar njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, nga AKP. Gjykata vlerëson se si paditësi ashtu edhe i padituri AKP edhe pse i din faktet në lidhje me funksionimin e kësaj NSH -je, gjegjësisht mos ushtrimin të aktiviteti ekonomik, pas vitit 1999 deri në fillimin e likuidimit dt. 04.06.2013, të njëjtit jo vetëm që nuk janë deklaruar, por as nuk kanë dorëzuar prova materiale. Prova e dorëzuar se paditësi ishte në listë të pagave, që është lëshuar nga Raiffesn Bank edhe sikur të ishte i saktë është provë e pa pranueshme sepse kjo provë është

dashur të lëshohet nga vet NSH –ja dhe jo nga subjekti tjetër. Me nenin 31.5 të Ligjit nr. 06/L-086 është paraparë, ,, Në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt , ajo palë është e obliguar të paraqesë prova , fizike dhe ose dëshmuese për mbështetjen e atij pohimi “. Me dispozitën e nenit 40 paragrafi 1. pika 1.6 .2, e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është parapa ,, kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në ” . Çështja e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës është e rregulluar edhe me Ligjin e Punës me nenin 76 Largimi kolektiv nga puna, ka paraparë mundësin e dëmshpërblimit të punëtorëve varësisht nga stazhi i punës, prej dy pagave mujore deri në shtat paga mujore. Gjykata palës paditëse dhe të paditur, ja dha mundësin që me Urdhër si më lartë të dorëzojnë provat në mbështetje të pretendimeve të tyre në lidhje me faktet . Me provën e formularit të kërkesës kreditore, vërtetohet se paditësi ka kërkuar për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës pa i precizuar numrin e pagave por ka kërkuar shumën 2,800.00€. Kështu që në rastin konkret barra e të provuarit bie si te paditësi ashtu edhe te i padituri AKP-së , pasi ajo e ka arkivin dhe tërë dokumentacionin e NSH. Gjykata vlerëson se qëllimi i kompensimit të punëtorëve të cilëve ju ndërpritet kontrata e punës në mënyrë të parakohshme si pasojë e ndryshimeve strukturore në Ndërmarrje i ligjvënësit është i karakterit social që punëtori varësisht nga stazhi i punës të përfitojë disa paga dhe me to ta mbajë vetën dhe familjen derisa të gjen ndonjë vend tjetër pune dhe këtë periudhë ta ketë më lehtë ta tejkaloj situatën sociale të shkaktuar për shkak të ndërprerës së parakohshme të marrëdhënies së punës. Në rastin konkret paditësi përkundër faktit se ju është lëshuar njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës, nga AKP-ja, në rastin konkret NSH nuk ka qenë subjekt që ka ushtruar aktivitetin e vet ekonomike, dhe për këtë arsye edhe nuk ishte i angazhuar në punë, kështu që paditësi ka pasur mundësi të punësohet te ndonjë punëdhënës tjetër për shkak të mos ushtrimit të veprimtarisë ekonomike NSH-ja. Në supozim se paditësi ka realizuar ndonjë të hyrë, nga NSH-ja, këtë të hyrë e ka realizuar nga të hyrat e NSH-së, nga qiratë e dhëna të objekteve-hapësirave te personat e tretë. Gjykata vlerëson se pavarësisht nga fakti i vërtetuar, se ndërprerja e marrëdhënies së punës juridikisht ka ndodhur më dt. 04.06.2013, në aspektin faktik, kjo ndërprerje ndodhur shumë më herët , paditësi

nuk ka kryer punë te NSH, nuk qenë punëtor aktivë, kjo gjendje statusore e tij në punë nuk i jep bazë juridike për të kërkuar dëmshpërblimin, në kuptim të nenit 40 paragrafi1, pika 1.6.2 e Shtojcës së Ligjit nr. 04/L -034.

Me datë 15 shtator 2024, paditësi përmes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGS, C-II-15-0067 C0001 të datës 02 gusht 2024 për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet padia si e bazuar. Për me tepër në ankesë paditësi ka pohuar se Shkalla e I-rë e ka nxjerrë Aktgjykimin e ankimuar duke shkelur dispozitat procedurale, dhe duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e cila nuk përputhet me prova që ai ka dorëzuar në gjykatë. Paditësi pohon se ka qenë në marrëdhënie pune në NSH "Bankos" nga data 19.02.1979 e deri me 04.06.2013, kur NSH-ja ka hyrë në likuidim. Paditësi pohon se ai ka pranuar Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punën me datë 04.06.2013, dhe po ashtu kjo vërtetohet edhe me Librezën e punës e cila është mbyllur me datë 04.06.2013. Tutje paditësi e konteston konstatimin e shkallës së I-rë se Lista e pagave është bërë nga një subjekt tjetër e jo nga NSH-ja, duke pohuar se kjo Listë është nga menaxhmenti i NSH-së I B, menaxher dhe B G, menaxher financiar, dhe ankuesi në këtë Listë është renditur në numrin rendor 14, dhe këto të hyra ankuesi i ka realizuar duke qenë se ka qenë punëtor i NSH-së. Po ashtu edhe nga gjendja e llogarisë bankare vërtetohet se paditësi ka pranuar pagë nga NSH-ja për muajt janar 2013(transferi i Bankës 2013). Paditë po ashtu pohon se atij i është njohur edhe e drejta legjitime për 20% nga shitja e ndërmarrjes, detaj të cilin shkalla e I-rë nuk e ka përmendur fare. Na ankesë paditësi i është referuar edhe një numëri të rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. Me ankesë ka bashkangjitur të gjitha provat që i kishte dorëzuar edhe në shkallën e I-rë të DHPGJS-së.

Me datë 22 tetor 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-

ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të ndryshohet .

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 23 korrik 2014, e ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ai ka kërkuar të kompensohet për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 2,800.00 euro nga NSH "Banka Themelore e Kosovës " (në likuidim). Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se paditësi nuk ka ofruar prova të për të vërtetuar se ai ka punuar në NSH në kohën e likuidimit të saj.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën dhe ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj duke nxjerrë konstatimin se provat e ofruara nuk janë të mjaftuara për të konstatuar se paditësi ka punuar në NSH apo ka marrë ndonjë pagë në kohën kur ka filluar procedura e likuidimit të NSH me datë 4 qershor 2013.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë me datë 12 janar 2015, dhe me parashtresat e më vonshme të tij ai ka dorëzuar kopjen e Librezës së punës e mbyllur me datë 04.06.2013, dy Lista të bankave lidhur me pagat e punëtorëve, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe Listën e AKP-së për drejtën legjitime për 20%.

Paditësi me Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës ka vërtetuar se ai ligjërisht ishte në punë në NSH deri me 04 qershor 2013, kur NSH-ja është privatizuar me vendimin e Bordit të Drejtoreve të AKP-së. Paditësi po ashtu ka dorëzuar Librezën e Punës e cila ishte mbyllur me datë 4 qershor 2013, si dhe dy lista të lëshuara nga Raiffeisen Bank që vërtetojnë që paditësi ka pranuar të hyra nga NSH-ja në vitin 2013.

Paditësi me këto prova mjaftueshëm ka vërtetuar se ai ishte në marrëdhënie pune në NSH para se NSH-ja të hyn në likuidim dhe ky fakt nuk ka mund të injorohet lehtësisht nga Shkalla e I-rë e DHPGJS.

Andaj ai ka të drejtë në kompensim pasi që me veprimin e AKP-së, i është ndërprerë marrëdhënia e punës, bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Paditësi tek Autoriteti i Likuidimit në emër të kompensimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës ka kërkuar shumën prej 2,800.00 euro, ndërsa me parashtresën e fundit të dorëzuar në Shkallën e I-rë të DHPGJS-SË të dorëzuar me 21 shkurt 2024 ai tani kërkon shumën prej 1,500.00 euro, interesin ligjor 10% në shumë prej 150.00 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit në shume prej 229 euro.

Kolegji i Apelit e ka marrë për bazë kërkesën e fundit të paditësit në shumë prej 1.500 euro, andaj kjo shumë është aprovuar në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Duke u bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së ligjit të AKP-së dhe nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit përveç borxhit kryesor i njihet edhe interesi ligjor prej 10 % në shumën themelore ose 150.00 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Ankuesja tashme e ka paguar taksen gjyqësore për procedurën ankimore me datë 3 tetor 2024 në shume prej 20 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 26 dhjetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____